



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01- Nr. 104/02-39077/2018
Kaçanik, 10.12.2018

Në bazë të nenit 18 dhe 19 të Rregullores nr.02-2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, dhe nenit 61 dhe 73, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për Formimin e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare

1. Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare -kapitale do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i organizatës buxhetore.

2. Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare-kapitale do të përbëhet nga pesë (5) anëtarë që janë zyrtar të organizatës buxhetore, dhe atë:

- | | |
|------------|--------------------|
| 1. Fadil | Qallaku (Kryesues) |
| 2. Zekirja | Koxha |
| 3. Adem | Axhami, |
| 4. Bujar | Bajra dhe |
| 5. Ekrem | Topalli |

3. Përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare-kapitale janë si në vijim dhe gjithpërfshirja fizike e tyre si:

3.1. Inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të Komunës;

3.2. Verifikimin fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare;

3.3. Krahësimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare;

3.4. Identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur;

3.5. Identifikimin e pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit;

3.6. Përgatitjen e raportit për kryerjen e inventarizimit, i cili duhet të hatrrohet deri më datën 08.01.2019

4. Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtori DEFZH, Kryesuesi i komisionit dhe anëtarët e Komisionit.

KRYETARI I KOMUNËS (ZKA)
Besim Ilazi



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipality of Kaçanik

01Nr. 104/02-39286/18

Në bazë të nenit 13.3 të Ligjit Nr.05/L125 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nenit 4 paragrafi 4.1 dhe 4.2, nenit 7 në harmoni të plot me nenin 8 pika 5, 7, 9 dhe nenit 19 të rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, në mbështetje të fermerëve, Kryetari i Komunës me rekomandimin e komisionit për vlerësim të kërkesave nxjerr këtë:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE TË FERMERËVE ME MJETE FINANCIARE PËR FARË GRURI DHE PLEH MINERAL

I

Lejohet ndarja e mjeteve financiare në shumë prej 12,990.00 €, për mbështetje të fermerëve që kultivojnë kulturën e grurit, në sipërfaqe prej 0.5- 1 ha, përfituesit e projektit mbështeten në shumë prej 75- 150€/ ha, për blerjen e farës së grurit dhe plehut mineral, varësisht nga sipërfaqja e mbjellur .

II

Shuma e mjeteve fermerëve përfitues do ti transferohet secilit llogarinë rrjedhëse bankare varësisht nga sipërfaqja e mbjellur, në bazë të marrëveshjes individuale, ofrimit të dëshmisë së fermerit (faturën e blerjes) dhe verifikimit nga komisioni komunal për posedimin- blerjen e farës së grurit dhe plehut mineral

III

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik (të fermerëve).
2. Mbështetja financiare publike për projektet /programet e drejtorisë do të ofrohet nga Buxheti i Komunës, kodi ekonomik 22200 në kuadër të programit subvencione dhe transfere me buxhetin e ndarë për vitin 2018

IV.

1. Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

V.

2. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është: Drejtoria e Financave, Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

VI.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Kryetari i komunës,

01-Nr. *104/02-40388/18*
Kaçanik, më 19.12.2018

Në mbështetje të neneve 13. Dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 02/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 të datës 4 Qershor 2008, komfor nenit 73 të Statutit të komunës të datës 25.09.2008 për përgjegjësitë e Kryetarit, nenit 20 të Ligjit të nr. 06/021 për Kontrollin e Brendshëm të financave publike, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit administrativ Nr.11/2010 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Sektorin Publik, Kryetari i komunës merr këtë:

VENDIM

Për riemërimin e anëtarit të Komitetit të Auditimit

1. Vedat Demës i vazhdohet mandati në pozitën e anëtarit të Komitetit të Auditimit.
2. Riemërimi i të përmendurit nga pika e I-rë të këtij vendimi, bëhet edhe për një mandat një vjeçar, anëtare i tretë i komitetit të auditimit të komunës së Kaçanikut.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të Kryetarit të Komunës.

Kryetari i komunës
Besim Ilazi



Me këtë vendim njoftohen:

- Vedat Demë, Kryetari i komunës, NJAB dhe Komiteti i auditimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 400/01-39708/h

Në bazë të nenit 13.3 të Ligjit Nr.05/L125 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nenit 4 paragrafi 4.1 dhe 4.2, nenit 7 në harmoni të plot me nenin 8 pika 5, 7, 9 dhe nenit 19 të rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, në mbështetje të fermerëve, Kryetari i Komunës me rekomandimin e komisionit për vlerësim të kërkesave nxjerr këtë:

VENDIM

Për mbështetje të fermerëve me mjete financiare për blerjen e mekanizmit bujqësor

I

Me këtë Vendim lejohet ndarja e mjeteve në shumë prej **39,432.00€**, fermerëve përfitues të projektit, për blerje të mekanizmit bujqësor (freza, makina shpërndarëse të plehut mineral dhe makina spërkatëse për kulturat lavërtare), për realizimin e projektit “Mbështetje të fermerëve me mekanizëm bujqësor” (freza, makina shpërndarëse të plehut mineral dhe makina spërkatëse).

II

Shuma e mjeteve e paraparë për fermerët përfitues të frezave është 584€, për fermerët përfitues të makinave shpërndarëse të plehut mineral 176€ si dhe për përfituesit e makinave spërkatëse 360€. Shuma e mjeteve secilit përfitues do të transferohet në llogarinë rrjedhëse bankare, në bazë të marrëveshjes individuale, ofrimit të dëshmisë së fermerit (faturën e blerjes) dhe verifikimit nga komisioni komunal për posedimin-blerjen e mekanizmit bujqësor (freza, makinë shpërndarëse të plehut mineral dhe makinë spërkatëse).

III

1. Për implementimin e njoftimit do të zbatohen dispozitat e rregullores për kushtet, kriteret, dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve për fermerë.
2. Mbështetja financiare publike për projektet /programet e drejtorisë do të ofrohet nga Buxheti i Komunës, në kuadër të programit për subvencione.

IV.

1. Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë njoftimit 08-320/01-35896/18, të datës 05.11.2018, për financimin e projektit të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, sipas dokumentacionit për zbatimin e njoftimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

V.

2. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është: Drejtoria e Financave, Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

VI.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi

